



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1927 Prot.
12

Tiranë, më 30.11.2022

Lënda: Njoftim mbi vetëkandidimin për anëtar të Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik (KPPA)

Prof.Dr. _____

KËTU

Në zbatim të pikës 1 (gërma “i”) të nenit 38, të pikës 3 dhe 5 të nenit 46 të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL e RSH”, i ndryshuar, VKM-së nr. 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës, si institucion i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e sportit në Republikën e Shqipërisë”; VKM nr. 112, datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standarteve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor”, i ndryshuar; gërmës “nj” të nenit 20 si dhe neneve 26, 27 të Statutit të UST-së, për krijimin e Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik në Universitetin e Sporteve të Tiranës, si strukturë përgjegjëse për dhënien e titujve “Profesor” dhe “Profesor i Asociuar”, Rregullores së veprimtarisë së KPPA,

Ftoheni të vetëkandidoheni për të qenë anëtarë të këtij Komisioni, nëse plotësoni kriteret e përcaktuara në pikën 4 të nenit 27 të Statutit të UST-së. Rregjistrimin mund ta bëni në zyrën e Protokoll-Arkivës së UST-së, nga data 30.11.2022 deri brenda orës 16:00 të datës 07.12.2022 ose/dhe në adresën contact@ust.edu.al

Mbetemi në pritje të vetëkandidimeve tuaja, në mënyrë që në mbledhjen e ardhshme të Senatit Akademik, të përzgjidhen anëtarët, që do të formojnë Komisionin e Promovimit të Personelit Akademik në Universitetin e Sporteve të Tiranës.

Faleminderit për mirëkuptimin!

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof.Dr. AGRON KASA

